



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumenti: 23.8f.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMPANISË
REGJIONALE TË UJITJES DRINI I BARDHË SH.A. PEJË PËR VITIN
E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë Sh.a., në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Spanca*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *udhëheqësja ekipit Ganimete Dalloshi dhe anëtarja ekipit Valmira Jonuzi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
5 Qeverisja.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	32
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	35
Shtojca III: Letër konfirmimi	42

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë Sh.a. për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 11/09/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë..

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë sh.a për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

Mohim i Opinionit

Për shkak të mungesës së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, ne nuk ishim në gjendje të japim opinion për PVF-të e vitit 2017.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Kompanisë Regionale të Ujitjes të Drinit të Bardhë sh.a (më tutje Drini i Bardhë). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Drinit të Bardhë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i PFV-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

PFV-të e miratuara nga BD përfshijnë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Mohim i opinionit

Ne ishim angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Drinit të Bardhë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për mohim të opinionit, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim opinion për këto pasqyra financiare.

Baza për mohim të opinionit

Ne nuk ishim në gjendje të shprehim opinion, për arsyet e përmendura në vijim:

1. Kërkesat tjera afatshkurtra të prezantuara në PFV ishin 11,1350€. Megjithatë, kompania nuk posedon dëshmi lidhur me përbërjen e kësaj shume dhe pavarësisht zbatimit të procedurave të auditimit ne nuk ishim në gjendje t'i konfirmojmë pohimet e auditimit.
2. Kompania në fund të vitit kishte bërë inventarizimin e asetëve dhe kishte përgatitur raportin për inventarizim i cili nuk përputhet me regjistrin e asetëve. Raporti i inventarizimit përmban 27 asetë (kanale të ujitjes) të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e asetëve, përderisa as raporti i inventarizimit nuk i përmban gjashtë asetë të cilat janë në regjistrin e asetëve, për të cilat ne nuk ishim në gjendje të përfitojmë evidenca lidhur me plotësinë dhe saktësinë e asetëve dhe si rrjedhojë e kësaj dhe zhvlerësimin e tyre.

3. Detyrimet ndaj punëtorëve (2008-2016) të prezantuara në PFV e vitit 2017 ishin 97,837€. Kompania ka ofruar dëshmi për obligime ndaj punëtorëve për periudhën 2013-2015 në vlerë prej 61,029€ dhe obligime për ish BD në vlerë prej 23,303€. Po ashtu, gjatë vitit 2017 kompania kishte paguar 17,885€, mirëpo këto pagesa nuk ishin reflektuar në zvogëlim të obligimeve. Më tej, kompania nuk posedon dëshmi për obligime ndaj punëtorëve për periudhën 2008-2012. Marrë parasysh nga ajo që u tha me lartë pavarësisht zbatimit të procedurave të auditimit ne nuk kemi qenë në gjendje të vërtetojmë gjendjen e këtyre obligimeve në fund të vitit pasi që kompania nuk posedon të dhëna lidhur me këto obligime.
4. Të hyrat e shtyera nga grantet të prezantuara në PFV ishin 2,608,651€. Mirëpo, kompania nuk posedon regjistrime kontabël lidhur me të hyrat e shtyera. Ndërsa, bazuar në regjistrin e pasurive vlera e granteve në fund të vitit 2017 ishte 1,554,732€, mirëpo, marrë parasysh se regjistri i aseteve nuk është i plotë nuk mund të marrim siguri se edhe vlera e aseteve të përfutuara nga grantet është e saktë dhe njëkohësisht të hyrat e shtyera të jenë të sakta. Si rrjedhojë e kësaj nuk mund të vërtetohen edhe të hyrat nga grantet në Pasqyrën e të Ardhurave.
5. Kapitali i emëruar i prezantuar në PFV ishte 1,147,934€. Përveç kapitalit themeltar që është cekur në statutin e kompanisë në vlerë 25,000€, kompania nuk posedon shënime kontabël apo dëshmi të tjera lidhur me përbërjen e kësaj shume. Ne nuk ishim në gjendje të kryejmë procedurat e rregullta të auditimit për këtë shumë.
6. Kompania nuk ka mbajtur regjistrime në kontabilitet lidhur me fitimet/humbjet e mbajtura dhe nuk ishte në gjendje të ofronte evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për këtë zë.
7. Llogaritë e arkëtueshme në PVF-të e vitit 2016 ishin 62,216€, ndërsa kompania gjatë vitit 2017 kishte njohur 48,960€ si shpenzime për borxhe të këqija. Menaxhmenti i kompanisë nuk ishte në gjendje të na ofrojë evidenca lidhur me llogarit të cilat i ka njohur si borxhe të këqija, dhe për shkak të këtij efekti ne nuk jemi në gjendje të vërtetojmë saktësinë e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit e cila ishte 45,361€.
8. Kompania tek të hyrat nga shitja e aseteve ka regjistruar të hyra në vlerë prej 15,066€ të cilat janë realizuar nga shitja e dy traktorëve, një ekskavatori dhe një kompresori, mirëpo kjo vlerë nuk është dashur të njihet si e hyrë, por të kalkulojë diferencën midis çmimit neto të shitjes dhe vlerës neto si fitime ose humbje nga shitja e pasurive jo qarkulluese në përputhje me SNK 16.
9. Si pasojë e mungesës së evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme, ne nuk ishim në gjendje të konfirmojmë saktësinë e pasqyrës së rrjedhës së parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet.
10. Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për zërat e prezantuara në PFV, për më shumë detaje shih nënkapitullin 3.6.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Drinit të Bardhë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një kompani private e auditimit, e cila kishte refuzuar të japë opinion për shkak të evidencave të pamjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për zërat e PFV-ve.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje dhe PFV-të

Kryesuesi i Bordit i Drinit të Bardhë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarim material të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Drinit të Bardhë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare vjetore në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi, dhe të japim një opinion të auditimit. Megjithatë, për shkak të çështjeve që janë përshkruar në paragrafin e bazës për mohim të opinionit, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit që të na jepte një bazë për opinionin e auditimit.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime); dhe
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore.
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:
 - Statuti i NP-së;

- Plani i Biznesit;
- Raporte tremujore;
- Raporte vjetore;
- Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në Memorandumin tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 10/10/2017, ne kemi ngritur disa çështje të cilat mund të kenë ndikim edhe në opinion. Çështjet e ngritura nuk ishin adresuar. Si pasojë, në draft pasqyrat financiare të datë 21/03/2018 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe shënimet shpjeguese. Përkundër sugjerimeve tona, ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për mohim të opinionit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, miratimi i bërë nga ZKA dhe ZKFTH, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në BD, mund të konsiderohet i pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë si në vijim:

- Plani i Biznesit përmban synimet afariste dhe financiare të cilat kompania synon ti arrijë gjatë vitit 2017 si dhe qasjen për realizimin e këtyre synimeve. Mirëpo, plani nuk përmban afatet kohore për realizimin e këtyre synimeve.
- Raportet tremujore për vitin 2017 të Drinit të Bardhë përmbajnë vetëm një shqyrtim të performancës financiare të tremujorit përkatës, kështu duke përmbushur vetëm një nga pesë kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen e raporteve tremujore siç e kërkon neni 31 i Ligjit të Ndërmarrjeve Publike.
- Kompania nuk kishte hartuar planin e prokurimit, siç kërkohet në nenin 8 të Ligjit për Prokurim Publik, pasi që nuk ka zyrtar të prokurimit.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për mohim të opinionit të auditimit dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet të cilat ndikuan të korrigjohen dhe të mos përsëriten.

Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Drini Bardhë. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Drinit Bardhë ishin të dobëta. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate dhe nuk janë mbështetur me rishikim të buxhetit gjatë vitit.

Më tutje edhe menaxhimi i shpenzimeve dhe të hyrave kanë nevojë për përmirësim. Kjo pasi që, blerja e mallrave dhe shërbimeve bëhet pa procedura të prokurimit, shpenzimet e kontributeve pensionale nuk prezantonin shpenzimet reale, mungon rregullorja për menaxhim të shpenzimeve për të siguruar kontrollet në këtë fushë. Aprovimi i vendimeve të bazuara në nene jo relevante, mungesa e rregullores për menaxhim të të hyrave, përcaktim i tarifave pa kritere për aplikim si dhe regjistrime jo të sakta kontabël janë tregues që kontrollet e brendshme në menaxhimin e të hyrave ishin të pamjaftueshme.

Po ashtu, kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurive jo qarkulluese, llogarive të arkëtueshme, arkës, detyrimeve, fitimeve të mbajtura nuk janë adekuate. Ato kanë pamundësuar regjistrimin dhe raportimin e saktë dhe të plotë të këtyre llogarive si në regjistrat kontabël ashtu edhe në PFV.

Gjithashtu edhe proceset e tjera si rekrutimi i punonjësve nuk ishte menaxhuar në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Angazhimi i punonjësve për punë pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues dhe mos njoftimi me shkrim i aplikantëve, e minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga Ujitja	53,500	50,845	37,346
Të hyrat nga shërbimet tjera	75,000	95,965	56,301
Të hyrat nga shitja e aseteve	0	15,066	0
Të hyrat nga grantet për investime kapitale - MZHE	650,000	194,114	105,751
Të hyrat nga marrëveshja me Komunën e Istogut	0	45,000	0
Të hyrat nga subvencionet MZHE	0	49,220	260,583
Gjithsej të hyrat	778,500	450,210	459,981
Shpenzimet për paga	109,870	121,232	95,799
Shpenzimet operative	8,500	14,760	14,273
Shpenzimet administrative	9,850	14,128	10,825
Shpenzimet tjera	0	0	95,764
Gjithsej Shpenzimet	128,220	150,120¹	216,661

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Planifikimi i të hyrave nga shitjet/shërbimet ishte dukshëm më i lartë sesa realizimi i vitit të kaluar. Të hyrat e realizuara në total janë 450,210€, që në raport me planifikimin janë realizuar më pak për 328,290€ ose 42%. Edhe pse të hyrat nga ujitja dhe nga shërbimet tjera kishin tejkaluar shumën e planifikuar. Megjithatë, mospërputhje ekzistojnë në planifikimin dhe realizimin e të hyrave nga grantet për investime kapitale - MZHE.
- Kompania nuk kishte bërë kalkulimet e duhura rreth shpenzimeve. Si rezultat i kësaj, shpenzimi i buxhetit në raport me planifikimin ishte tejkaluar për 21,900€ apo 17%. Planifikim i dobët vërehet tek të gjitha kategoritë, e sidomos tek shpenzimet operative dhe administrative, ku realizimi është shumë më i lartë se sa vlera e planifikuar. Kjo përqindje e lartë e shpenzimeve ka të bëjë me atë se kompania gjatë planifikimit nuk ishte bazuar në shpenzimet e vitit paraprak.

¹ Për dallim nga Pasqyra e të Ardhurave, totali i shpenzimeve në këtë tabelë nuk përfshinë shpenzimet për borxhet e këqija në vlerë prej 48,960€.

Çështja 2 - Planifikim jo i mirë i buxhetit dhe mos rishikimi i tij

- E gjetura** Në planin e biznesit, Drini i Bardhë kishte prezantuar planifikimin e buxhetit për vitin 2017. Realizimi i të hyrave në raport me planifikimin ishte vetëm 58%. Ndërsa, vlera e shpenzimeve të planifikuara ishte tejkaluar për 17%. Devijime sidomos janë vërejtur tek të hyrat nga grantet për investime kapitale nga MZHE ku vlera e planifikuar ishte 650,000€, mirëpo në bazë të marrëveshjes së Mirëkuptimit me MZHE-ne të datës 22.02.2017 shuma e aprovuar ishte vetëm 300,000€. Po ashtu, kompania në planin e buxhetit lidhur me shpenzimet nuk kishte planifikuar disa nga shpenzimet të cilat kanë ndodhur. Megjithatë, kompania një gjë të tillë nuk e kishte mbështetur me një rishikimin të buxhetit ku do të reflektohej në planin e të hyrave si dhe të shpenzimeve për të siguruar menaxhimin e duhur të kompanisë.
- Rreziku** Proceset e dobëta të planifikimit duke mos i marrë në konsiderate edhe shkaqet të cilat mund të ndodhin gjatë vitit rrezikon që kompania të mos arrij objektivat dhe të mos arrij t'i mbulojë shpenzimet duke rritur obligimet ndaj furnitorëve.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që plani i biznesit bazohet në mundësitë reale të kompanisë dhe realizimi i të hyrave dhe shpenzimeve monitorohet në mënyrë sistematike dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestare të reflektohen në një plan të rishikuar.

3.2 Pasqyra e pozitës financiare (Balanci i gjendje)

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrës së pozitës financiare, duke i testuar gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare të Drinit Bardhë më 31 dhjetor 2017

Pasuritë	Viti 2017	Viti 2016	Detyrimet dhe Ekuiteti	Viti 2017	Viti 2016
Paratë e gatshme në Bankë	145,929	129,896	Llogaritë e pagueshme	1,033	152,320
Paratë në Arkë	578	0	Detyrimet ndaj pagave të punëtorëve	97,837	0
Llogaritë e arkëtueshme	45,361	62,216	Detyrimet Tatimore	2,007	0
Kërkesat tjera afatshkurtra	11,135	11,135	Të hyrat e shtyera	2,608,652	2,517,537
Parapagimet	234	234	Kapitali i pronarëve	1,147,934	1,147,934
Toka, ndërtesat dhe pajimet	3,743,701 ²	3,859,701	Fitimet e bartura	245,392	130,301
Investimet në vijim	216,992	0	Fitimi i vitit	61,075	115,091
Gjithsej Pasuritë:	4,163,930	4,063,182	Gjithsej Detyrimet dhe Ekuiteti	4,163,930	4,063,183

² Kjo shumë përbehet nga: Toka në vlerë prej 924,200€, Ndërtesat në vlerë 513,394€, Pasuritë- Kanalet e ujitjes në vlerë 2,300,291€ dhe Pajisjet e blera gjatë vitit në vlerë 5,815€.

Çështja 3 – Menaxhim i dobët i parasë së gatshme që mbahej në arkë

- E gjetura** Kompania ka një numër inkasantësh në terren të cilët mbledhin para të gatshme për shërbimet e ofruara për klientët. Këto mjete pasi mblidhen nga inkasantët dorëzohen në arkë, mirëpo vetëm një pjesë e tyre depozitohet në llogarinë bankare, kurse pjesa tjetër shfrytëzohet për shpenzime nëpërmjet arkës. Testimet tona tregojnë regjistrime jo të sakta, pasi që dalja e parasë nga arka ishte për 211€ më e lartë se hyrjet e parasë në arkë. Po ashtu, kompania nuk kishte rregullore të brendshme për menaxhimin e arkës ashtu siç kërkohet në nenin 7 të Statutit të Drinit të Bardhë. Më tej, kompania nuk kishte caktuar komision për konfirmimin e gjendjes së arkës në fund të vitit, me ç’rast shuma e prezantuar në PVF nuk mund të konfirmohet si e saktë pasi që shënimet kontabël nuk na japin një saldo të tillë.
- Rreziku** Mos depozitimi i mjeteve në llogarinë bankare, pamundëson identifikimin e saktë të arkëtimeve. Ndërsa mungesa e rregullores për menaxhim të arkës rrezikon një menaxhim jo të duhur të saj. Me tej, mos caktimi i komisionit për konfirmim të gjendjes së arkës në fund të vitit si dhe regjistrimet jo të sakta kontabël ndikojnë në prezantim jo të saktë të PVF-ve.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që inkasantët pasi të depozitojnë mjetet në arkë, ato menjëherë të depozitohen në llogarinë bankare. Kurse, nëpërmjet nxjerrjes së një rregullore të veçantë për menaxhim të arkës të caktohet shuma për mbushjen e arkës, e cila tërhiqet nga banka me përskrim përkatës. Ndërsa në fund të vitit të caktoj komision përkatës për konfirmimin e gjendjes së arkës, duke siguruar vlerë të saktë të parasë në arkë dhe në PVF.

Çështja 4 – Dobësi evidente në menaxhimin e Llogarive të arkëtueshme

E gjetura Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme përcillet me parregullsi. NP nuk ka politika se si t'i trajtoj llogaritë e akumuluar vite me radhë dhe për trajtimin e borxheve të këqija. Me tej, nuk ka ndonjë analizë për moshën e llogarive dhe ndonjë vlerësim nëse ato mund të inkasohen.

Mangësi janë identifikuar edhe me rastin e konfirmimit të llogarive të arkëtueshme nëpërmjet letër konfirmimeve. Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se:

- Në një rast sipas konfirmimit të klientit vlera e borxhit ndaj kompanisë është 0€, ndërsa në regjistrat e kompanisë vlera e borxhit që ky klient i detyrohet kompanisë është 1,345€. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos definimit të saktë lidhur me pagesën e detyrimit të tatimit në qira, të cilën klienti e ndal nga vlera mujore e faturës.
- Në një rast shuma e borxhit të konfirmuar nga inkasanti është për 712€ më e ultë se shuma në regjistrat kontabël. Për shkak të regjistrimeve jo të sakta të ditarit të arkës ne nuk ishim në gjendje të konfirmojmë saktësinë e kësaj shume; dhe
- Në një rast borxhi i konfirmuar nga klienti ishte zero, ndërsa shuma e borxhit në regjistra kontabël ishte 3,600€. Sipas zyrtares së financave kjo ka ndodhur si pasojë e mos harmonizimeve të të dhënave me klientët.

Rreziku Proceset e dobëta të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, si mungesa e politikave për trajtimin e llogarive të arkëtueshme, mungesa e analizave lidhur me moshën e këtyre llogarive, si dhe diferencat në mes të letër konfirmimeve dhe regjistrave kontabël, ndikojnë në pasaktësinë e këtij zëri në PFV.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit duhet që siguroj nxjerrjen e një politike të brendshme lidhur me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, të forcoj kontrollin e kontabilitetit në mënyrë që të mbahen regjistrime të sakta dhe të bëhen harmonizime me klientët. Gjithashtu, Bordi duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të këtyre llogarive dhe në rastet kur janë plotësuar kushtet ligjore, ato të evidentohen si borxhe të këqija dhe të pa mbledhëshme. Ndërsa, për llogaritë tjera, të përcaktoj strategjinë se si dhe brenda cilave afate do të inkasohen.

Çështja 5 – Menaxhimi i dobët pasurive jo qarkulluese

E gjetura	<p>Gjatë auditimit të pasurive jo qarkulluese janë identifikuar mangësitë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">• Sipas nenit 7 të Statutit të Drinit të Bardhë, kompania duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e saj. Kompania nuk kishte nxjerr ndonjë rregullore për menaxhimin e pasurisë e cila duhet të përshtatet me nevoja dhe kërkesat e kompanisë duke u mbështetur në standardet dhe rregullat në fuqi.• Shënimet e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm në hartimin e pasqyrave financiare. Ne kemi vërejtur se Investimet në vijim nuk ishin regjistruar në regjistra kontabël, por shuma e prezantuar në PFV ishte vendosur duke u bazuar vetëm nga pagesat nëpërmjet bankës.• Drini i Bardhë gjatë vitit 2017, përmes një procedure të prokurimit kishte blerë një pasuri (kalldaj) dhe material shpenzues (pelet). Me rastin e regjistrimit në kontabilitet kompania, përveç pasurisë kishte regjistruar edhe peletin në vlerë 1,750€ si pasuri, edhe pse peleti është material shpenzues. Këto regjistrime ishin reflektuar edhe në PVF. Një regjistrim i tillë mbivlerëson pasuritë në vlerë 1,750€ dhe nënvlerëson shpenzimet.• Përveç blerjeve të pasurive gjatë vitit 2017, kompania nuk ka regjistruar pasuritë jo qarkulluese në regjistrin kontabël. Këto pasuri janë të regjistruara vetëm në një raport përmbledhës të formatit Excel. Sipas menaxhmentit të kompanisë kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së definimit të pronësisë së pasurive.
Rreziku	<p>Në mungesë të një rregulloreje të brendshme dhe të një regjistri të plotë dhe të saktë në kontabilitet rritet rreziku për një menaxhim jo të mirë të pasurive dhe keqpërdorimit të mundshëm të tyre.</p>
Rekomandimi 5	<p>Kryesuesi i Bordit duhet që brenda një afati sa më të shkurtër të hartoj një rregullore të brendshme mbi menaxhimin e pasurive, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për përdorimin e pasurive (të drejtat dhe detyrimet e stafit). Po ashtu, të sigurojë regjistra të plotë dhe të saktë kontabël për të gjitha pasuritë e kompanisë.</p>

Çështja 6 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve tatimore

- E gjetura** Çdo deklarues i Tatimit të Vlerës së Shtuar (TVSh) është i obliguar që me rastin e shitjeve të kalkuloje edhe TVSh-në e mbledhëshme. Gjatë testimit të të hyrave kemi vërejtur se në 16 raste në vlerë 20,237€, kompania nuk kishte kalkuluar dhe deklaruar TVSh, edhe pse këto shitje nuk ishin të liruara nga TVSh-ja.
- Rreziku** Mos faturimi dhe deklarimi i TVSh-se sjell nënvlerësim të detyrimeve tatimore dhe rrjedhimisht pasqyra jo të sakta financiare. Gjithashtu, rrezikohet të ndëshkohen nga Administrata Tatimore.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që të bëhen korrigjimet e nevojshme dhe me rastin e procedimit të faturave të shitjes të kalkulohet dhe deklarohet TVSh-ja.

Çështja 7 - Prezantim jo i saktë i llogarive të pagueshme

- E gjetura** Vlera e llogarive të pagueshme në fund të vitit ishte 1,033€. Megjithatë, testimet tregojnë se në një rast kompania nuk kishte njohur detyrimet e tatimit në pronë në vlerë prej 1,762€ shumë kjo e konfirmuar nëpërmjet letër konfirmimit. Por, në regjistrat e kompanisë ekziston shuma 570€ si parapagim. Kjo ka ndodhur për shkak të regjistrimeve jo të sakta në kontabilitetin e kompanisë.
- E gjetura** Mos regjistrimi i saktë i detyrimeve rrezikon që ndaj kompanisë të aplikohen procedura përmbartimore dhe kompanisë ti shkaktohen kosto shtese. Po ashtu, kjo ndikon në prezantim jo të saktë të llogarive të pagueshme.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të forcoj kontrollet e brendshme me rastin e regjistrimit të shënimeve financiare. Po ashtu, të siguroj se janë bërë harmonizimet e nevojshme me furnitorët dhe të korrigjoj gabimet në shënimet kontabël, dhe pastaj të ndërmerren veprimet e nevojshme për t'i paguar detyrimet ndaj furnitorëve.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Kompania Regionale e Ujitjes Drini i Bardhë në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017 (në €)

Të hyrat	Viti 2017	Viti 2016
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	146,810	93,647
Të hyrat nga shitja e asetëve	15,066	0
Të hyrat nga marrëveshja me Komunën e Istogut	45,000	0
Të hyrat nga Subvencionet MZHE	49,220	260,583
Të hyrat nga grantet	125,877	105,751
Total të hyrat	381,973	459,981
Shpenzimet e pagave	121,233	95,799
Shpenzimet e administrative	14,128	10,825
Shpenzimet e operative	14,761	14,273
Shpenzimet për borxhet e këqija	48,960	0
Shpenzimet e zhvlerësimit	121,816	128,229
Shpenzimet tjera	0	95,764 ³
Total shpenzimet	320,898	344,890
Fitimi/Humbja para tatimit	61,075	115,091

³ Shpenzimet tjera paraqesin: 82,263.58€ tërheqje nga përmbaruesi privat për obligimet e pa kryera dhe 13,500€ shpenzimet për pagat e pa marrura.

Çështja 8 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave

- E gjetura** Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi vërejtur mangësitë në vijim:
- Sipas nenit 7 të Statutit të Drinit të Bardhë, kompania duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e sajë. Kompania nuk kishte nxjerrë ndonjë rregullore, ku do të përcaktoheshin rregullat, kushtet dhe procedurat për menaxhimin e të hyrave.
 - Sipas Ligjit nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore neni 8, tarifat të cilat duhet ti paguajnë shoqatat dhe fermerët përcaktohen nga Bordi Mbikëqyrës i kompanisë përkatëse. Kompania nuk kishte nxjerr një tarifore në të cilën do të përcaktohen tarifat me rastin e kryerjes së shërbimeve. Mirëpo, BD kishte nxjerr vendime për përcaktimin e tarifave duke u bazuar në nenin 31.3 të Ligjit për NP-të dhe në bazë të nenit 14 pika 2.1.11 të statutit të kompanisë. Mirëpo këto nene rregullojnë mënyrën e raportimit vjetor dhe tremujor dhe jo mënyrën e përcaktimit të tarifave.
 - Bazuar në statutin e saj, kompania aktivitet kryesor e ka ofrimin e shërbimeve të furnizimit të ujitjes. Përveç këtyre shërbimeve, kompania gjatë vitit kishte realizuar të hyra edhe nga pëlqimet të cilat i lëshon me rastin e kërkesave nga personat fizik dhe juridik të cilat kërkojnë të kenë qasje në pronat e kompanisë. Mirëpo, sa i përket tarifave për pëlqime, BD kishte nxjerr një vendim në të cilin ishte përcaktuar që pagesa minimale të jetë 100€, ndërsa shuma tjetër varet nga vlerësimet e komisioneve, duke mos përcaktuar kritere për aplikim të tarifave. Si pasojë e kësaj, në gjashtë raste në vlerë 2,600€ ishin aplikuar tarifa të ndryshme, për të cilat vetëm në një rast komisioni kishte caktuar tarifën, ndërsa në raste tjera ishte e pa mundur të identifikohet se me rastin e faturimit kush e kishte përcaktuar tarifën.
- Rreziku** Mungesa e rregullores rrit rrezikun që të hyrat të jenë subjekt i gabimit apo manipulimit. Ndërsa aprovimi i vendimeve i bazuar në nene ligjore jo adekuate, sjell në dyshim validitetin e këtyre vendimeve. Më tej, vendimi jo adekuat për përcaktimin e tarifave, pa u bazuar në kritere me rastin e lëshimeve të pëlqimeve rrezikon që faturime të ndryshme për shërbime të njëjta, kjo ndikon në uljen e reputacionit të kompanisë dhe mundësinë e padive gjyqësore.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është nxjerrë një rregullore për menaxhimin e të hyrave, duke përcaktuar procedura dhe kontrole të qarta, duke u mbështetur në standardet dhe rregullat në fuqi. Po ashtu, të sigurojë nxjerrjen e një tariforeje për shërbimet që i ofron, duke u bazuar në kritere të qarta dhe në bazë ligjore përkatëse.

Çështja 9 – Mos zbatimi i procedurave të prokurimit

E gjetura Ndërmarrjet Publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim që të respektojnë të gjitha procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Ne kemi vërejtur që kompania nuk zhvillon procedura të prokurimit me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve, përveç me rastin e blerjeve të pasurive jo qarkulluese.

Për me tepër kompania në 10 raste në vlerë 3,588€, nuk kishte kontratë për furnizim me mallra dhe shërbime, në të cilën do të specifikonte të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Po ashtu nuk kishte një proces formal të pranimit të mallrave dhe shërbimeve.

Rreziku Mosrespektimi i LPP, rrezikon që fondet publike për blerje të mos përdoren në mënyrë transparente dhe të mos respektohet konkurrenca e tregut. Më tej, blerjet e bëra duke mos u mbështetur në kontratë dhe pa proces formal të pranimit nuk japin siguri për ndodhjen dhe saktësinë e shpenzimeve.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që blerjet e mallrave dhe shërbimeve bëhen në harmoni të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik në mënyrë që të arrihet transparenca dhe konkurrenca e nevojshme dhe të sigurohet shfrytëzimi efikas i fondeve publike. Po ashtu, nëpërmjet përcaktimit të komisioneve përkatëse, të siguroj një proces formal të pranimit të mallrave dhe shërbimeve.

Çështja 10 - Mungesa e rregullore për menaxhim të shpenzimeve

E gjetura Kompania nuk kishte ndonjë rregullore për menaxhimin e shpenzimeve dhe furnizimeve, e cila duhet të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e kompanisë, ashtu siç kërkohet me nenin 7 të statutit të kompanisë. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit të rëndësisë së rregullore për menaxhimin e shpenzimeve dhe furnizimeve.

Rreziku Mungesa e rregullore për menaxhimin e shpenzimeve dhe furnizimeve krijon paqartësi në administrimin e buxhetit dhe rritë mundësinë e gabimeve në procedimin e pagesave.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Bordit duhet të nxjerrë një rregullore të brendshme për menaxhimin e shpenzimeve dhe furnizimeve, duke i bërë të qarta përgjegjësitë e zyrtarëve, procedurat e pranimit të furnizimeve, format dhe periudhat e raportimit të tyre.

Çështja 11 - Mos prezantim i saktë i kontributeve pensionale të punëdhënësit

- E gjetura** Shuma e kontributeve pensionale e prezantuar në Pasqyrën e të Ardhurave ishte 9,620€. Mirëpo, bazuar në listën totale të pagave, shpenzimet e kontributeve të punëdhënësit ishin 5,572€. Kjo ka ndodhur për shkak të regjistrimeve jo të sakta në kontabilitet dhe mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme.
- Rreziku** Mos regjistrimi dhe mos prezantimi i saktë i kontributeve pensionale, rezulton me mbivlerësim të shpenzimeve dhe rrjedhimisht në zvogëlimin e fitimit të vitit.
- Rekomandimi 11** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që do të behën korrigjimet e nevojshme dhe regjistrime të sakta të shumave të prezantuara në pasqyra financiare.

Çështja 12 - Menaxhimi i burimeve njerëzore jo në përputhje me kërkesat ligjore

- E gjetura** Gjatë testimit të kësaj kategorie janë identifikuar mangësitë si në vijim:
- Sipas Ligjit të Punës neni 8, Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Në pozita të ndryshme të punës gjatë vitit ishin angazhuar shtatë punëtorë sezonal, për të cilat vende pune nuk ka pasur konkurse publike. Kompania kishte themeluar marrëdhënie pune me kontratë pune për kohë të caktuar nga tre deri në nëntë muaj; dhe
 - Sipas udhëzimit administrativ nr. 14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, kërkohet që kandidatët e përzgjedhur duhet të ftohen me shkrim së paku 48 orë para testimit. Në një proces të rekrutimit, kandidatët nuk ishin ftuar me shkrim për t'iu nënshtruar testit ose intervistës, por ishin ftuar vetëm përmes telefonit.
- Rreziku** Punësimet pa konkurs publik si dhe mos njoftimi i kandidatëve me shkrim krijojnë papajtueshmëri, kufizim të konkurrencës dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.
- Rekomandimi 12** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e angazhimeve të stafit të ri zhvillohen procedura konkurrimi dhe respektohen të gjitha kërkesat ligjore.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të kompanisë, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Kapitali i Drinit të Bardhë më 31.12.2017

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
KAPITALI	1,454,401	1,393,326
Kapitali themeltar	1,147,934	1,147,934
Fitimet/Humbjet e bartura	245,392	105,164
Fitimet/Humbja e vitit aktual	61,075	82,374
Saldo balancuese		66,831

Mangësitë lidhur me prezantimin e kapitalit janë prezantuar tek baza për opinion.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve afariste, financiare dhe investimit. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paratë neto nga aktiviteti operative	148,304.00	(59,628)
Të hyrat para tatimit	61,075	115,091
Shpenzimet e zhvlerësimit	121,816	128,229
Të hyrat nga zhvlerësimi i granteve	(34,762)	(260,583)
Rregullimet tjera akruale	(14,197)	(8,871)
Shpenzimet e borxheve të këqija	48,960	-
Llogaritë e pagueshme	(51,443)	(29,054)
Llogaritë e arketueshme	16,855	(4,440)
Parasë neto nga aktiviteti investuese	(222,807)	(106,351)
Blerja e mjeteve themelore	(5,815)	(24,087)
Investimet në vijim	(216,992)	(82,264)
Paratë neto nga aktivitetet financiare	91,115	295,191
Të hyrat e shtyra nga grantet	91,115	295,191
Neto rritja / (zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të saj	16,612	129,212
Paraja dhe ekuivalentët të saj me 1 janar 2017	129,896	683
Paraja dhe ekuivalentët të saj me 31 dhjetor 2017	146,508	129,895

Mangësitë lidhur me prezantimin e rrjedhës së parasë janë prezantuar tek baza për opinion.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja 13 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese**E gjetura**

Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ose pasqyrën e rrjedhës së parasë, duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Gjatë analizës së shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Nuk ishin prezantuar informacione shpjeguese lidhur me pasuritë jo qarkulluese, zhvlerësimin e tyre, rritjet ose zvogëlimet;
- Informacione jo të detajuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme, edhe pse gjatë vitit kompania kishte njohur shpenzime për borxhe të këqija.
- Nuk ishin prezantuar informacione shpjeguese, lidhur me llogaritë e pagueshme, obligimet ndaj pagave të punëtorëve (2008-2016) dhe detyrimet tatimore.
- Po ashtu, informacione shpjeguese nuk ishin prezantuar edhe për të hyrat e shtyra nga grantet, kapitalin e emëruar dhe fitimin dhe humbjen nga vitet paraprake.
- Nuk ishin prezantuar informacione lidhur me detyrimet/pasuritë kontigjente edhe pse ekzistojnë raste gjyqësore.

Këto kanë ndodhur shkakun e mungesës së konsultimit të SNK-ve dhe funksionimit të sistemit të kontroleve të brendshme për identifikimin e korrigjimeve të nevojshme me kohë.

Rreziku

Prezantimi jo i plotë dhe mangësitë e informacioneve në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare, paqartësinë e shifrave të prezantuara si dhe kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të rezultateve financiare dhe afariste të kompanisë.

Rekomandimi 13 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

PFV-të e vitit 2016 të Drinit Bardhë ishin audituar nga një kompani private e auditimit. Raporti i përgatitur nga auditori i jashtëm kishte rezultuar me mohim të opinionit për shkak të evidencave të pamjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit të cilat janë prezantuar tek baza për opinion. Po ashtu, auditori kishte përgatitur edhe një letër menaxhment në të cilën ishin prezantuar gjashtë rekomandime. Kompania nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, asnjë nga çështjet e prezantuara tek baza për opinion nga auditimi i vitit 2016 nuk ishin zbatuara. Ndërsa, sa i përket rekomandimeve të dhëna në letër menaxhment vetëm tri rekomandime janë në proces të zbatimit dhe tri nuk janë adresuar ende.

Po ashtu, nga auditimi i vitit 2015 tek çështjet e prezantuara tek baza për opinion vetëm dy rekomandime ishin në proces të zbatimit, kurse gjashtë të tjera nuk ishin zbatuar ende. Ndërsa, sa i përket rekomandimeve të dhëna në letër menaxhment vetëm tri rekomandime janë në proces të zbatimit dhe dy nuk janë adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 14 – Zbatim i ulët i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të mos hartimit të Planit të Veprimit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm të vitit të kaluar dhe atyre të bartura nga viti i mëhershëm asnjë nga rekomandimet nuk ishin zbatuar plotësisht. Ne kemi vërejtur se Drini Bardhë nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake rrit rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me PFV dhe me menaxhimin financiar dhe kontrollet e brendshme.

Rekomandimi 14 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili i përcakton afatet kohore për zbatimin e tyre dhe stafin përgjegjës, fillimisht duke u fokusuar në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja

Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Drinit Bardhë, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut, cilësinë e raportimit menaxherial, mungesa e kodit të etikës, mungesa e lejes ujore dhe mungesa e një ueb faqeje të internetit për publikimin e rregulloreve dhe raporteve për qëllime të transparencës. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si dhe përgjigjja ndaj rekomandimeve të auditimit të brendshëm, ende janë larg standardeve të kërkuara.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një staf e cili njëherit është Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Drinit të Bardhë dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Çështja 15 - Mungesa e marrjes parasysh e punës së auditorit të brendshëm nga Menaxhmenti

E gjetura Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2017. Hartimi i planit ishte bazuar në nivelin e rrezikut për sistemet dhe proceset e përfshira në auditim. Nga pesë auditime të planifikuara, katër prej tyre ishin përfunduar. Përmes këtyre raporteve NjAB i kishte ofruar informata menaxhmentit se sa efektive janë kontrollet e brendshme dhe funksionimi i tyre. Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqe dhe në ngjarjet aktuale të kompanisë. Komiteti i auditimit kishte shqyrtuar të gjitha rekomandimet e NjAB. Pavarësisht rekomandimeve të dhëna nga NjAB, njësitë e audituara pas raportit nuk kishin hartuar plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe NjAB, kishte realizuar edhe 10 auditime tjera jashtë planit me kërkesë të komisionit të auditimit, tri prej të cilave përfshinë aktivitete të periudhave nga 2009 deri 2016.

Rreziku Mos hartimi i planeve të veprimit për zbatim të rekomandimeve nga njësitë e audituara, rrisin rrezikun që kontrollet të jenë jo efikase në parandalimin e mangësive në aktivitetet operative të kompanisë. Kjo mund të rezultojë me vazhdimin e praktikave joefektive dhe përsëritjen e mangësive të njëjta. Ndërsa realizimi i auditimeve duke përfshirë aktivitetet të periudhave paraprake ndikon në mos identifikimin me kohë të dobësive të kontrolleve të brendshme dhe përmirësimet e tyre të jenë të vonuara.

Rekomandimi 15 Kryesuesi i Bordit të siguroj që njësitë e audituara përgatisin plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së, të analizojë shkaqet e mos adresimit të rekomandimeve dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre. Po ashtu të siguroje që kërkesat e auditimeve jashtë planit të përfshijnë aktivitetet e ngjarjeve aktuale e jo të periudhave shumë të largëta.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe manaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, manaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 16 - Moszbatimi i plotë i kërkesave për menaxhimin e rrezikut

E gjetura Kryeshefi Ekzekutiv i kompanisë është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçe dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për menaxhimin e këtyre rreziqeve. Përcaktimi i rreziqeve, ndikimi i tyre, veprimet që duhet të ndërmerren dhe përgjegjësia për veprimet, dokumentohen në një Regjistër Rreziku.

Kompania në Planin e Biznesit ka identifikuar kërcënimet – rreziqet të cilat mund të ndikojnë në dobësimin e aftësisë së kompanisë drejt arritjes së objektivave. Mirëpo, nuk kishte përgatitur planin për menaxhimin e këtyre rreziqeve. Këto për shkak të llogaridhënies dhe kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme.

Rreziku Mungesa e planit të menaxhimit të rreziqeve mund të ndikojë negativisht në arritjen e objektivave të kompanisë. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk ndërmerren në mënyrë të planifikuar, sistematike dhe në kohën e duhur.

Rekomandimi 16 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e planit për menaxhimin e rreziqeve, të delegoj përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës, të siguroj raportim mujor për zbatimin e kërkesave ndaj rreziqeve duke përfshirë vlerësimin e ndikimit të tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe përgjigjet ndaj tyre.

Çështja 17 - Ndarje jo e duhur e detyrave

- E gjetura** Drini i Bardhë ka të vendosur strukturën e saj organizative, mirëpo nuk kishte bërë ndarje të qartë të detyrave. Kontrollat menaxheriale të zbatuara në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm nuk kanë identifikuar delegim dhe ndarje të duhur të detyrave. Të gjitha të hyrat dhe shpenzimet i menaxhon vetëm një zyrtarë, e cila është e autorizuar të procedoj, aprovoj, regjistroj dhe raportoj të gjitha transaksionet. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm për të bërë ndarjen e duhur të detyrave.
- Rreziku** Autorizimi dhe ndarja jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësive redukton kontrollin efektiv dhe aftësinë e menaxhmentit për të monitoruar në mënyrë aktive të hyrat dhe shpenzimet e kompanisë.
- Rekomandimi 17** Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të delegimit të përgjegjësive dhe llogaridhënies duke siguruar ndarje të duhur të detyrave dhe qartësimin e përgjegjësive të deleguara. Të sigurohet gjithashtu që detyrat dhe funksionet në mes zyrtarit autorizues dhe atij që bënë regjistrimin e transaksioneve të jenë të ndara.

Çështja 18 - Mungesa e vazhdimet të lejes ujore

- E gjetura** Drini Bardhë nuk kishte arritur të siguroj Lejen Ujore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ujërat në Kosovë nr. 04/L-147 (neni 71 pika 1). Edhe përkundër përpjekjeve për sigurimin e saj, nga muaji gusht i vitit 2014, Drini i Bardhë vazhdon të punoj pa leje ujore, për shkak se organi kompetent (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) i kishte refuzuar kërkesën si të pa kompletuar.
- Rreziku** Mungesa e lejes ujore, krijon rrezikun që kompania të përballet me masa ndëshkimore nga organet kompetente, duke sjell kompaninë në një situatë të vështirë financiare.
- Rekomandimi 18** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë kompletuar dokumentet e nevojshme për aplikim sa më shpejt që është e mundur në mënyrë që të shmangë refuzimin e kërkesës nga Ministria kompetente dhe të arrij të sigurojë Lejen Ujore.

Çështja 19 - Mos përgatitja e kodit të etikës nga ana e kompanisë

- E gjetura** Sipas nenit 35, të Ligjit nr. 03/L-087 për NP-të, të gjitha ndërmarrjet publike duhet të përgatisin, miratojnë dhe zbatojnë një kod të detyrueshëm të etikës dhe qeverisjes korporative. Kodi i etikës dhe qeverisjes korporative e obligon NP-në për zbatimin e standardeve më të larta të mirësjelljes dhe praktikave afariste. Gjatë auditimit konstatuam se Drini Bardhë ende nuk kishte arritur ta përgatis dhe as të miratoj një kod të etikës. Sipas tyre, ata zbatojnë Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, mirëpo asnjë nga drejtorët dhe zyrtaret e Drinit Bardhë nuk kishin zbatuar nenin 1.5 të këtij kodi, ku kërkohet që nga secili drejtor ta nënshkruaj këtë Kod.
- Rreziku** Mungesa e një kodi të etikës rrezikon mos zbatimin e standardeve të larta të mirësjelljes nga stafi dhe menaxhmenti i kompanisë.
- Rekomandimi 19** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e masave të nevojshme për të hartuar dhe miratuar një kod të etikës sipas kërkesave të ligjit për NP-të dhe të njëjtin ta nënshkruajnë menaxhmenti dhe zyrtaret e kompanisë.

Çështja 20 - Mos publikimi i dokumenteve në ueb faqen e internetit të kompanisë

- E gjetura** Neni 34.2 i Ligjit për ndërmarrjet publike kërkon që një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të NP-së do të publikohet dhe mbahet në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP-ja. Gjithashtu, kërkohet të publikohet: plani i biznesit, raportet tre mujore dhe raportet vjetore. Drini Bardhë ende nuk ka funksionale një ueb faqe të internetit për ti publikuar rregulloret dhe raportet e saj për qëllime të transparencës.
- Rreziku** Mos publikimi i raporteve të ndryshme dhe rregulloreve të kompanisë në një ueb faqe të internetit krijon mos respektim të ligjit dhe mungese të transparencës së kërkuar.
- Rekomandimi 20** Kryesuesi i Bordit duhet të vë në funksion një ueb faqe të internetit të kompanisë dhe të publikojë të gjitha rregulloret, raportet dhe dokumentet që i kërkon ligji i ndërmarrjeve publike, për qëllim të transparencës ndaj publikut.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Kompania nuk ka mbajtur regjistrime të kontabilitetit të dyfishtë dhe nuk ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me SNRF-të ashtu siç kërkohet me Ligjin Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Me qëllim të balancimit të pasqyrës se pozitës financiare menaxhmenti ka paraqitur një zë në ekuitet si saldo balancuese në vlerë prej 420,175€, kjo llogari nuk është e evidentuar mirëpo është paraqitur si saldo balancuese.			Jo, nuk janë marrë masa.
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpjeguar në shënimin 4 dhe 5, për llogarite e arketueshme me 31.12.2015 në vlerë prej 57,776€ dhe kërkesat tjera afatshkurtra me 31 dhjetor në vlerë prej 11,135€ nuk ishim në gjendje që me anë të procedurave standarde dhe alternative të auditimit të përftojmë evidenca për vërtetësinë e kësaj llogarie.			Jo, nuk janë marrë masa
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpjeguar në shënimin 6, për llogarinë toka, ndërtesat dhe pajisjet me 31.12.2015 në vlerë 3,835,614€, menaxhmenti nuk ka ofruar dëshmi apo certifikata të pronësisë që vërtetojnë të drejtat pronësore të kompanisë.			Jo, nuk janë marrë masa.

Pasqyra Financiare Baza për opinion	Gjatë vitit 2015 NP ka pranuar granate investive nga MZHE në vlerë prej 308,125€, ku këto mjete janë shfrytëzuar për investime kapitale sipas marrëveshjes së granteve dhe nuk janë paraqitur në PFV si pasuri e NP-se. Mosparaqitja e këtyre investimeve në PFV si pasuri të kompanisë nënvlerëson pasuritë e NP-se.			Jo, nuk janë marrë masa.
Pasqyra Financiare Baza për opinion	<p>Sic është shpjeguar në shënimin 7, për Llogaritë e Pagueshme me 31.12.2015, në vlerë prej 175,702€, menaxhmenti ka ofruar dëshmi vetëm për shumën 116,958€ që paraqet obligimet të pagave të punëtorëve nga vitit 2009-2015. Obligimet për paga para vitit 2009 nuk janë pasqyruar në PFV në këtë llogari. Kompania nuk mban regjistra ku paraqiten saktë të gjitha obligimet ndaj punëtorëve dhe anëtarëve të BD.</p> <p>Në këtë llogari po ashtu, nuk janë përfshirë obligimet ndaj operatorit ekonomik në vlerë 79,857€, për punët e kryera gjatë vitit 2014, edhe pse ekziston vendimi nga gjykata për këto obligime të kompanisë dhe si rrjedhojë e këtij obligimi gjatë vitit 2016, kompanisë i janë bllokuar llogarite bankare.</p> <p>Mos përfshirja e të gjitha obligimeve të kompanisë në PFV, shtrembëron paraqitjen e drejtë të pozicionit financiar dhe rezultatit të performances.</p>			Jo, nuk janë marrë masa
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Sic është shpjeguar në shënimin 8, në llogarinë të hyrat e shtyra nga grantet me 31.12.2015, në shumën 2,222,346€ nuk është paraqitur vlera e granteve të përfituara gjatë vitit 2015 në vlerë prej 308,125€.			Jo, nuk janë marrë masa.

Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpjeguar në shënimin 9, për llogarinë të hyrat, kompania ka njohur të hyrat nga operacionet në bazë të pranimit të parasë se gatshme dhe jo në bazë të parimit akrual sipas kërkesave të SNRF-ve, në bazë të cilave është e obliguar ti përgatis pasqyrat financiare.		Ka filluar njohjen e të hyrave nga operacionet sipas parimit akrual, mirëpo nuk janë bërë korrigjimet e nevojshme për periudhat paraprake.	
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Shpenzimet e pagave janë paraqitur sipas pagesave të bëra të punëtorëve dhe jo sipas ndodhjes së këtyre shpenzimeve. Në bazë të SNRF-ve kompania duhet të paraqes shpenzimet sipas parimit akrual atëherë kur ndodhin e jo kur paguhen. Paraqitja e shpenzimeve në bazë të pagesave nënvlerëson shpenzimet reale të ndodhura gjatë periudhës dhe shtrembëron paraqitjen e drejte të rezultatit financiar të kompanisë.		Kompania nuk kishte bërë korrigjimet e nevojshme. Mirëpo gjatë vitit 2017, kishte njohur shpenzimet sipas parimit akrual.	
Pasqyra Financiare Letër menaxhment	Rekomandojmë që sa më parë kompania të zbatojë procedura të duhura të kontrollit të cilat mundësojnë që transaksionet dhe ngjarjet ekonomike të regjistrohen në sistemin e kontabilitetit dhe të raportohen me kohë. Gjithashtu kompania të identifikojë të gjitha transaksionet e paregjistruara deri më tani në mënyrë që të korrigjojë pasqyrat financiare gjatë vitit 2016.			Jo, nuk janë marrë masa.
Paraje e Gatshme Letër menaxhment	Menaxhmenti të dizajnoje procedura të kontrolleve të brendshme në fushën e parasë së gatshme ku do të bëhet ndarja e detyrave dhe ku i njëjti person nuk do të bëjë aprovimin, procesimin dhe regjistrimin e transaksioneve.		Është bërë autorizimi dhe për ZKF-në, mirëpo nuk janë regjistruar transaksionet e vitit 2015 në regjistrat kontabël. Regjistrime kontabël janë bërë vetëm për 2016 dhe 2017.	

Pasqyra Financiare Letër menaxhment	Menaxhmenti të sigurojë një sistem të kontabilitetit të përshtatshëm për regjistrim të kontabilitetit të dyfishtë dhe që do të mundësonte gjenerimin e raporteve dhe pasqyrave financiare me kohë.		Kompania ka të vendosur sistemin për mbajtje të kontabilitetit të dyfishtë, mirëpo mungon regjistrimi i transaksioneve.	
Obligimet ndaj punëtorëve Letër menaxhment	Menaxhmenti të implementojë procedura dhe kontrole adekuate në fushën e pagave. Të mbahen regjistra të hyrje/daljeve me nënshkrime të punëtorëve apo softuer për menaxhimin e kohës së kaluar në punë nga punëtorët, gjithashtu të përgatitet një llogari e saktë me të gjitha obligimet ndaj punëtorëve.		Mbahen evidenca lidhur me hyrje/dalje të punëtorëve, mirëpo mungon një llogari e saktë lidhur me obligimet ndaj punëtorëve.	
Obligimet Letër menaxhment	Menaxhmenti të përfshijë të gjitha obligimet e kompanisë në pasqyrat financiare.			Jo, nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet ë vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Kompania nuk ka mbajtur regjistrime të mjaftueshme në kontabilitet për të ofruar evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për disa nga shifrat e paraqitura në PFV.			Jo, nuk janë marrë masa
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpjeguar në shënimin 4 dhe 5, për Llogarite e Arketueshme me 31.12.2015 në vlerë prej 62,216€ dhe kërkesat tjera afatshkurtra me 31.12.2016 në vlerë prej 11,135€, menaxhmenti ka ofruar dëshmi vetëm për shumën 3,250, kurse për pjesën tjetër nuk ishin në gjendje që me anë të procedurave standarde dhe alternative të auditimit të përfitojmë evidenca për vërtetësinë e kësaj llogarie.			Jo, nuk janë marrë masa

Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpjeguar në shënimin 6, për llogarinë toka, ndërtesat dhe pajisjet me 31.12.2016 në vlerë 3,887,930€, menaxhmenti nuk ka ofruar dëshmi apo certifikata të pronësisë që vërtetojnë të drejtat pronësore të kompanisë.			Jo, nuk janë marrë masa
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpjeguar në shënimin 7 për llogarinë e pagueshme me 31.12.2016 në vlerë 152,320€ menaxhmenti nuk ka ofruar dëshmi dhe nuk kemi mundur të verifikojmë, edhe pse në vitin paraprak menaxhmenti ka ofruar dëshmi për shumën 116,958€ që janë obligime për paga të punëtorëve nga viti 2009-2015. Në vitin 2016 kompania i ka paguar 66% të obligimeve të punëtorëve, mirëpo këto pagesa janë regjistruar si shpenzim i periudhës dhe llogarite e pagueshme nuk janë zvogëluar për këtë shumë. Obligimet për paga për vitin 2009 nuk janë paraqitur në PFV në këtë llogari. Kompania nuk mban regjistra ku paraqiten saktë të gjitha obligimet nga punëtorëve dhe anëtarëve të BD.			Jo, nuk janë marrë masa
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpjeguar në shënimin 8, llogaria të hyrat e shtyra nga grantet me 31.12.2016 ka vlerën prej 2,517,537€. Kjo llogari përmban të gjitha pasuritë jo qarkulluese të pa zhvlerësuar të përfituara nga grantet qeveritare. Mirëpo, pasi që kompania nuk ka të dhëna të sakta lidhur me hyrat dhe pagesat për kanalet e ndërtuara nga këto mjete ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë shumën e saktë të këtyre të hyrave të shtyra.			Jo, nuk janë marrë masa.

Pasqyrat Financiare Letër menaxhment	Sa me parë kompania të implementoj procedura te duhura te kontrollit të cilat mundësojnë qe transaksionet dhe ngjarjet ekonomike të regjistrohen në sistemin e kontabilitetit dhe të raportohen me kohë. Gjithashtu rekomandojmë që kompania të identifikoj të gjitha transaksionet e pa regjistruara deri me tani në mënyrë që ti korrigjoe pasqyrat financiare gjatë vitit 2016.			Jo, nuk janë marrë masa.
Pasuritë jo qarkulluese të përfutuara nga grantet Letër menaxhment	Menaxhmenti të ndërmarrë hapa ne definimin e pronësisë në zyrën kadastrale për të gjitha asetet për të cilat ka pretendime pronësore kompania. Gjithashtu kompania për të gjitha asetet e saja duhet të ketë në funksion procedura për testimin e vlerës se asetëve dhe përfshirjen e te gjitha asetëve në PF.			Jo, nuk janë marrë masa
Paraja e gatshme Letër menaxhment	Menaxhmenti të dizajnojë procedura të kontrolleve të brendshme në fushën e parasë se gatshme ku do të behet ndarja e detyrave dhe ku i njëjti person nuk do të bëjë aprovimin, procesimin dhe regjistrimin e transaksioneve.			Jo, nuk janë marrë masa
Regjistrat e kontabilitetit – Teknologjia Informative Letër menaxhment	Menaxhmenti të siguroje një sistem të kontabilitetit të përshtatëshëm për regjistrim të kontabilitetit të dyfishtë dhe që do të mundësonte gjenerimin e raporteve dhe pasqyrave financiare në kohë.		Kompania ka të vendosur sistemin për mbajtje të kontabilitetit të dyfishtë, mirëpo për disa zëra financiar mungon regjistrimi i transaksioneve.	

Pagat Letër menaxhment	Menaxhmenti të implementojë procedura dhe kontrole adekuate në fushën e pagave të mbahen hyrje/daljet me nënshkrime të punëtoreve apo softuer për menaxhimin e kohës se kaluar ne pune nga punëtorët. Gjithashtu të përgatitet një llogari e saktë me të gjitha obligimet ndaj punëtorëve.		Mbahen evidenca lidhur me hyrje/dalje të punëtoreve, mirëpo mungon një llogari e saktë lidhur me obligimet ndaj punëtorëve	
Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme Letër menaxhment	Ridizajnimin e sistemit te kontabilitetit i cili do të mundësonte që të gjitha faturat e lëshuara nga kompania të regjistrohen dhe të përfshihen në pasqyrat financiare. Në këtë mënyrë kompania në çdo kohë do të ishte ne dijeni për borxhet që palët tjera kanë ndaj kompanisë. Gjithashtu rekomandojmë që menaxhmenti i kompanisë se bashku me departamentin e kontabilitetit dhe financave të identifikojë të gjitha llogaritë e vjetra që janë bartur nga vitet e mëhershme dhe të vendos për trajtimin e tyre.		Kompania ka vendosur sistemin e kontabilitetit, mirëpo nuk ka ndërmarre veprime për trajtimi e llogarive të vjetra që janë bartur nga vitet e mëhershme dhe të vendos për trajtimin e tyre.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudrinibardhe.com

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të NPDrinit të BardhëSh.A., për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Data: 21.05.2018